



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORË**
**Gjyqtari i Seancës Paraprake
(GJSP)**

Nr. Regj.Them. 520003-00194-61-2025 (361)
Datë regjistrimi 24.01.2025

Nr. 61-2025-1535 (313) Vendimi
Datë 13.05.2025

VENDIM
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”
PËR KTHIMIN E AKTEVE



**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë me trup gjykues të
përbërë prej:**

GJYQTARE: ALBA NGRESI

Me sekretare gjyqësore Belinda Haxhiaj, në Vlorë, më datë 13.05.2025, pasi përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, kërkesën penale me Nr. 520003-00194-61-2025 (361) Regj.Them., datë regjistrimi 24.01.2025, datë e ardhjes së dosjes pranë këtij trupi gjykues 25.01.2025 që i përket:

KERKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përfaqësuar nga Prokurore Znj. Flora Çela (Zhvilluar gjykimi në mungesë të pjesëmarrjes).

OBJEKTI:

Pushimin e procedimit penal nr. 787, regjistruar në datë 21.03.2017, për veprat penale “Falsifikimi i dokumentave” dhe “Fshehjes së pasurisë pas falimentimit”, të parashikuara nga nenet 186 dhe 195, të K.Penal.

ME KALLËZUES:

Z. Rrapo Xhaferraj, me adresë: Lagjja “Hajro Çakërri”, rruga “Sulejman Delvina”, shtëpi private nr. 143, Vlorë, me nr. celulari. 0693099166 (në mungesë).

PERSON NËN HETIM:

Znj. Bukurie Haxhiraj, me adresë: Lagjja “28 Nëntori”, rruga “Gjergj Kastrioti”, shtëpi private pranë ish Uzinës Metalike, Vlorë, me nr. celulari: 0682053250(në mungesë).

BAZA LIGJORE:

Nenet 327/6 gërma “a”, 328/1, gërma “dh” dhe 329/a të K.Pr.Penale, si dhe neni 66 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në mungesë të prokurores të çështjes Znj. Flora Çela, në mungesë të kallëzuesit të veprës penale dhe të personit nën hetim, Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes, çmoi provat e marra në seancë paraprake,

VËREN:

I. Procedura.

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka paraqitur pranë kësaj Gjykate në datën 24.01.2025, shortuar me shortin elektronik datë 24.01.2025, kërkesën penale nr. 3618 Regj.Themeltar, me objekt: *“Pushimin e procedimit penal nr. 787, regjistruar në datë 21.03.2017, për veprat penale “Falsifikimi i dokumentave” dhe “Fshehjes së pasurisë pas falimentimit”*, të parashikuara nga nenet 186 dhe 195, të K.Penal.

2. Gjykata pasi mori fizikisht dosjen penale brenda afatit ligjor të sanksionuar në K.Pr.Penale, konkretisht nenet 332 dhe 332/a, ka marrë vendim duke caktuar seancën e parë paraprake. Gjithashtu, Gjykata paraprakisht konstatoi se, bazuar në nenet 69, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të kësaj gjykate gjykimi i saj.

3. Në zbatim të nenit 332, paragrafi 1, të K.Pr.Penale, kjo çështje penale u shqyrtua me trup gjykues të përbërë nga 1 (një) gjyqtar. Gjykata në vështrim të neneve 15-18 të K.Pr.Penale, çmoi se nuk ekzistojnë për të shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim.

4. Sa më sipër, bazuar në nenin 329/a, pika 2 e K.Pr.Penale, Gjykata me urdhrin e datës 29.01.2025, caktoi datën e seancës paraprake dhe urdhëroi sekretarinë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve procedurale përkatëse. Seanca paraprake e datës 14.04.2025 nuk u zhvillua për shkak të mosformimit të trupit gjykues, duke u caktuar seanca e radhës për në datë 13.05.2025, ora 09:30.

5. Në seancën paraprake të datës 13.05.2025, Gjykata pasi çeli seancën, kreu veprimet paraprake, të cilat konsistonin në verifikimin e paraqitjes së palëve, organi procedues, pavarësisht marrjes dijeni nuk u paraqit. Njëherazi dhe letërthirrjet drejtuar kallëzuesit të veprës penale dhe personit nën hetim ishin kthyer nga shërbimi postar, por ata nuk u paraqitën në seancë paraprake. Në këto kushte Gjykata vijoi me zhvillimin e gjykimit në mungesë të tyre.

II. Rrethanat e faktit.

6. Me Urdhrin e datës 21.03.2017 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. 787, për veprën penale *“Falsifikimi i dokumentave”*, parashikuar nga nenet 186 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit penal të kryer nga shtetasi Rrapo Xhaferraj.

6.1 Nga rrethanat e çështjes rezultoi se: Me vendimin nr. 1758, datë 06.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “A & B Group” sh.p.k, duke u emëruar si administrator i falimentimit kallëzuesi, z. Rrapo Xhaferaj.

6.2 I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit, kallëzuesi Rrapo Xhaferaj ka deklaruar se, nga ana e shtetases Bukurie Haxhiraj, në cilësinë e administratores së shoqërisë “A & B Group” sh.p.k, ka patur përpjekje për t’a penguar kallëzuesin për kryerjen e detyrës së tij në cilësinë e administratorit të falimentimit dhe konkretisht në arkëtimin e shumave të parave të nxjerra nga shitjet në llogarinë bankare të përfaqësura prej tij, situatë e cila ka zgjatur deri në datën 29.09.2016, kur nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur likuidimi i shoqërisë. Sipas kallëzuesit, duke filluar nga data 29.09.2016, shtetasja Bukurie Haxhiraj nuk ka pranuar të kryente inventarizimin fizik të mallrave dhe të depozitonte në llogarinë e shoqërisë arkëtimet ditore nga të gjitha pikat e shitjes në posedimin e saj. Mbi bazën e ankimit të paraqitur nga ana e kallëzuesit Rrapo Xhaferaj, me vendimin Nr. 185, datë 23.11.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, është vendosur ndryshimi i vendimit datë 29.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe pranimi i kërkesës së administratorit të falimentimit për paraqitjen e një plani organizimi. Kallëzuesi ka deklaruar se, gjatë kësaj periudhe kohore, shtetasja Bukurie Haxhiraj ka kryer veprime juridike me shuma parash, pa kontrollin dhe autorizimin e tij si administrator i falimentimit.

6.3 Ka rezultuar se, në datën 09.12.2016, nga ana e shtetases Bukurie Haxhiraj, mbi bazën e autorizimit të datës 09.12.2016, sipas së cilit kallëzuesi Rrapo Xhaferaj autorizonte këtë shtetase për të kryer veprime në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pa dijeninë e tij si administrator i falimentimit, është kryer një aplikim pranë QKB, i cili ka sjellë pasoja sepse është vendosur riemërimi i administratorit të shoqërisë dhe sipas ekstraktit të QKB-së të dorëzuar në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT)-Dega Vlorë, janë hapur llogari bankare në emër të shtetases Bukurie Haxhiraj, si dhe është revokuar e drejta e firmës së administratorit të falimentimit pa vendim gjykate, duke e kthyer shoqërinë në gjendje aktive, në kundërshtim me urdhërimet e vendimit Nr.1758, datë 06.11.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6.4 Nga informacioni i ardhur nga ana e Qendrës Kombëtare të Biznesit, ka rezultuar se, në datën 09.12.2016, shtetasja Bukurie Haxhiraj ka aplikuar në këtë institucion, duke dorëzuar dokumenta që ndryshojnë kohëzgjatjen e administratorit të shoqërisë “A&B Group” sh.p.k dhe pjesë e këtyre dokumentave kanë qenë: (i). Autorizimi i datës 09.12.2016, i lëshuar nga shtetasi Rrapo Xhaferaj, i cili autorizonte shtetasen Bukurie Haxhiraj për kryerjen e veprimeve në QKB. (ii). Karta e identitetit të shtetases Bukurie Haxhiraj. (iii). Vendimi i ortakut të vetëm Agron Haxhiraj, datë 09.12.2016. (iv). Vendimi Nr.185, datë 23.11.2016 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

6.5 Kallëzuesi Rrapo Xhaferaj ka deklaruar se, autorizimi i datës 09.12.2016, i përdorur nga ana e shtetases Bukurie Haxhiraj pranë QKB-së dhe pranë BKT-së, është i falsifikuar, pasi as shkrimi dhe as firma në këtë autorizim nuk i përkasin atij. Njëkohësisht, kallëzuesi Rrapo Xhaferaj ka deklaruar se, sipas detyrave të caktuara nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në cilësinë e administratorit të falimentimit ka proceduar me bllokimin e menjëhershëm të llogarive bankare të shoqërisë, ka kryer inventarizimin fizik të mallrave dhe materialeve dhe ka ofruar riorganizimin e shoqërisë, aktiviteti i së cilës ka vazhduar normalisht deri në datën 29.09.2016, kur nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur likuidimi i shoqërisë.

6.6 Shtetasja Bukurie Haxhiraj ka deklaruar se, nuk ka patur dijeni në lidhje me personin që ka bërë ndryshimin në QKB, duke mohuar faktin që të ketë qenë ajo personi që ka bërë depozitimin e kërkesës në QKB.

6.7 Nga deklarimet e punonjësës së QKB-së, e cila ka marrë aplikimin e shtetasës Bukurie Haxhiraj, ka rezultuar se, aplikimi është bërë pikërisht nga shtetasja Bukurie Haxhiraj, e cila ka plotësuar edhe formularin përkatës të aplikimit. Kjo shtetase ka deklaruar se, sipas rregullores së brendshme të institucionit, origjinali i aplikimit dhe dokumentat i kthehen përsëri aplikuesit. Nga informacioni i ardhur nga QKB, ka rezultuar se, në bazë të ligjit, ky institucion nuk ka detyrim që të ruajë aplikimin dhe dokumentat bashkëlidhur.

6.8 Nga informacioni i ardhur nga BKT, Dega Vlorë, ka rezultuar se ekstrakti i ndryshuar në QKB, ku pasqyrohet heqja e shtetasit Rrapo Xhaferaj si administrator i falimentimit të shoqërisë dhe emërimi i shtetasës Bukurie Haxhiraj si administratore e shoqërisë, është depozituar në bankë nga vetë shtetasja Bukurie Haxhiraj, e cila rezulton të ketë veprime në llogarinë bankare nga data 28.02.2017 deri në datë 21.03.2017, kur në bankë është paraqitur shtetasi Rrapo Xhaferaj, në cilësinë e administratorit të falimentimit.

6.9 Kallëzuesi Rrapo Xhaferaj ka deklaruar se, ai nuk ka bërë mbylljen e llogarisë së shoqërisë dhe hapjen e një llogarie të re në emër të tij, por edhe pas hapjes së procedurës së falimentimit ka vijuar që t'i kryejë veprimet në të njëjtën llogari bankare. Ai ka deklaruar se, në shoqërinë në falimentim, e kishte punësuar shtetasen Bukurie Haxhiraj në pozicionin e Drejtores Ekzekutive të shoqërisë, për shkak edhe të rrethanave të posaçme familjare të saj me shtetasin Agron Haxhiraj (bashkëshortja e tij).

6.10 Nga ana e organit procedues nuk është bërë e mundur pyetja e shtetasit Agron Haxhiraj, për shkak se ai rezulton të ketë ndërruar jetë, fakt ky i provuar nga administrimi i certifikatës përkatëse të vdekjes.

7. Nisur nga sa sipër, në datën 12.09.2018, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, është paraqitur përpara kësaj gjykate (gjyqtarit të seancës paraprake), kërkesa penale, me objekt: *"Pushimin e procedimit penal Nr. 787 të vitit 2017"*, me arsyetimin se, në kushtet kur nuk është bërë e mundur administrimi i kopjes origjinale të dokumenave të pretenduara si të falsifikuara, nuk mund të arrihet të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm falsifikimi i këtyre dokumentave, për shkak të pamundësisë së kryerjes së një akti ekspertimi kriminalistik.

7.1 Me vendimin Nr. 1483 datë 22.10.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: *"1. Rrëzimin e kërkesës. 2. Kthimin e akteve të procedimit penal Nr. 787 të vitit 2017, Prokurores së çështjes, znj. Elona Alvora, me qëllim kryerjen e këtyre veprimeve hetimore të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi. 3. Veprimet hetimore si më sipër, duhet të kryhen brenda 2 (dy) muajsh, nga dita që ky vendim do të marrë formë të prerë. 4. Urdhërohet sekretaria gjyqësore për njoftimin e këtij vendimi Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim vetëm nga ana e Prokurores, në Gjykatën e Apelit Vlorë, brenda 10 (dhjetë) ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi"*.

7.2 Pas ankimit të organit procedues, vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë me vendimin Nr.744 datë 04.12.2018. Në vendimin Nr. 1483 datë 22.10.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka lënë kryerjen e këtyre detyrave:

- (i) Së pari, në drejtim të provueshmërisë së falsitetit të dokumentit “Autorizim, datë 09.12.2016” i cili është përdorur nga ana e shtetases Bukurie Haxhiraj pranë QKB-së dhe BKT-Dega Vlorë. Në lidhje me provueshmërinë e këtij fakti, gjykata vlerëson se, nga ana e organit të prokurorisë duhet të procedohet me kryerjen e një akti ekspertimi grafik të shkrimit dhe nënshkrimit, më ekspertë të fushës së kriminalistikës. Në lidhje me kryerjen e këtij veprimi hetimor, gjykata vlerëson se, ai mund të kryhet edhe në mungesë të origjinalit të dokumentit, duke u bazuar në fotokopjen e tij dhe rezultatet e aktit të ekspertimit duhen vlerësuar në unitet edhe me deklaratimet e kallëzuesit z. Rrapo Xhaferaj, i cili gjatë gjithë fazës së hetimit paraprak, ka mohuar lëshimin e një autorizimi të tillë në favor të shtetases Bukurie Haxhiraj, duke deklaruar se, shkrimi dhe nënshkrimi në këtë dokument nuk janë të tijat.
- (ii) Së dyti, duke patur në konsideratë atributin kushtetues të organit të prokurorisë, si i vetmi organ i cili ka tagrin kushtetues të ushtrimit të ndjekjes penale në Republikën e Shqipërisë, gjykata vlerëson se, në rastin objekt shqyrtimi, nga ana e organit të prokurorisë do të duhet të kryhen hetime edhe në lidhje me veprën penale të “Fshehjes së pasurisë pas falimentimit”, parashikuar nga neni 195 i Kodit Penal.

7.2.1 Gjithashtu, në vendimin Nr. 1483 datë 22.10.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vlerësuar ndër të tjera se: “Në analizë të elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni 195 i Kodit Penal, duke patur në konsideratë, së pari, statusin juridik të shoqërisë “A & B Group” sh.p.k, si një shoqëri në falimentim, për administrimin e pasurisë të së cilës është caktuar nga gjykata edhe administratori i falimentimit z. Rrapo Xhaferaj, me qëllimin final, garantimin e shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve të saj dhe së dyti, natyrën e veprimeve të kryera nga ana e shtetases Bukurie Haxhiraj, e cila dyshohet se përmes një dokumenti të falsifikuar ka kryer veprime pranë QKB-së dhe BKT-Dega Vlorë, me qëllim fshehjen e pasurisë së personit juridik për t’iu shmangur pasojave juridike të falimentimit, gjykata vlerëson se, nga ana e organit të prokurorisë duhet të kryhen hetime edhe në lidhje me këtë figurë të veprës penale”.

7.3 Në datë 08.06.2020 nga ana e Prokurisë është riparaqitur kërkesa për pushimin e këtij procedimi duke arsyetuar se janë kryer veprimet hetimore të caktuara nga gjykata. Sipas akt ekspertimit Nr. 2196 datë 06.03.2020, ka rezultuar:

“1. Dorëshkrimet objekt të drejtëpërdrejta ekspertimi të plotësimit të përmbajtjes së tekstit si dhe shkrimit emër mbiemër “Rrapo Xhaferaj” e nënshkrimi (firma) poshtë tij e ndodhur në dokumentin objekt ekspertimi e titulluar “AUTORIZIM” datë 09.12.2016 e lëshuar në emër të shtetases Bukurie Haxhiraj nuk është shkruar dhe nënshkruar nga shtetasja Bukurie Haxhiraj krahasuar me modelin e krahasimit të paraqitura në emër të saj.

2. Dorëshkrimet objekt të drejtëpërdrejta ekspertimi të plotësimit të përmbajtjes së tekstit si dhe shkrimit emër mbiemër “Rrapo Xhaferaj” e nënshkrimi(firma) poshtë tij e ndodhur në dokumentin objekt ekspertimi e titulluar “AUTORIZIM” datë 09.12.2016 e lëshuar në emër të shtetases Bukurie

Haxhiraj nuk është shkruar dhe nëshkruar nga shtetasi Rrapo Xhaferraj krahasuar me modelet e krahasimit të paraqitura në emër të tij”.

7.4 Nga ana e organit të akuzës është administruar dhe vendimi Nr.949 Rregj Themeltar datë 16.01.2019 i Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me të cilin është miratuar plani i riorganizimit të shoqërisë “A&B Grup” sh.p.k dhe vendimi Nr. 184 datë 05.11.2019.

7.5 Referuar veprimeve hetimore të kryera dhe të dhënave që kanë rezultuar pre tyre, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë çmon se procedimi penal Nr.787 i vitit 2017 filluar për hetimin e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 i Kodit penal duhet të pushohet pasi dokumentat nuk mund të gjenden në origjinal duke bërë të pamundur të provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm fakti penal objekt hetimi që lidhet me falsitetin mekanik (pasi ekzaminimet të anës teknike nuk mund të kryhen sipas ekspertëve. Ndërkohë lidhur me parashikimin e nenit 195 të Kodit Penal Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë çmon se nuk jemi përpara kësaj veprë penale në rastin e pagës së furnitorëve të shoqërisë në proces falimentimi (me procedurën e riorganizimit sipas dhe vendimeve gjyqësore të vitit 2019 që kanë miratuar dhe shpenzimet) ky fakt nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në këto kushte, organi procedues ka paraqitur përsëri kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për pushimin e çështjes penale Nr.787/2017.

7.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me Vendimin Nr. 859 (61-2020-5040), datë 29.12.2020 në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka vendosur: “Kthimin e akteve të çështjes penale Nr. 787 të vitit 2017 regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave” parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë duke urdhëruar kryerjen e këtyre veprimeve hetimore: 1. Plotësimin e akt ekspertimit duke kryer dhe ekspertimin e vulës në dokumentin “Autorizim” datë 09.12.2016, si dhe të nënshkrimit në dokumentin “Aplikim” pranë QKB-që tek rubrika “Aplikuesi” datë 09.12.2016. 2. Të verifikohet se nga kush është administruar vula e subjektit A&B Grup sh.p.k në momentin e lëshimit të këtyre akteve. Këto veprime të kryhen brenda një afati 2 muaj.”.

7.6.1 Më gjerësisht, Gjykata ka arsyetuar ndër të tjera se: “ Në rrethanat e përmendura më lart, gjykata vlerëson se duke pasur parasysh pretendimet e kallëzuesit dhe veprimet hetimore të caktuara me vendimin Nr. 1483, datë 22.10.2018, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë aktet t'i kthehen prokurorit duke urdhëruar: -Plotësimin e akt ekspertimit, duke kryer dhe ekspertimin e vulës në dokumentin “Autorizim” datë 09.12.2016, si dhe të shkrimit dhe nënshkrimit në dokumentin “Aplikim” pranë QKB-së te rubrika “Aplikuesi” datë 09.12.2016. -Të verifikohet se nga kush është administruar vula e subjektit “A&B” Group sh.p.k në momentin e lëshimit të këtyre akteve. Bazuar dhe në këto prova, të rivlerësohet nëse do të paraqitet kërkesa për pushim apo duhet të kryhen dhe veprime të tjera hetimore dhe të konkludohet më kërkesë për pushim apo formulim akuze dhe dërgimin për gjykim.”.

7.7 Me vendimin nr. 40, datë 16.03.2021, Gjykata e Apelit Vlorë, ka lënë në fuqi vendimin nr. 859, datë 29.12.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

8. Në datë 07.02.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ka marë vendim “Për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit teknik grafik”, duke caktuar ndaj ekspertit pyetjet sa vijon: “5.1. Në dokumentin objekt ekspertimi

(përshkruar në pikën a), vula e ndodhur në këtë dokument me logon “REPUBLIKA E SHOIPËRISË, A&B GRUP SHPK, L.11 JANARI, 113-VLORË ALBANIA”, a është formuar nga e njëjta klishe vule e ndodhur në dokumentet model krahasimi (përshkruar në pikën e)? 5.2. Dokumenti objekt ekspertimi, (përshkruar në pikën b), në fletën numërtuar 27 (njëzet e shtatë), në cepin poshtë djathtas, a është nënshkruar nga shtetasja Bukurie Haxhiraj, krahasuar me dokumentet model krahasimi (përshkruar në pikat c, d, e, f)? 5.3. Dokumenti objekt ekspertimi, (përshkruar në pikën b), në fletën numërtuar 28 (njëzet e tetë), në rekuizitën “Nënshkrimi” datë 09.12.2016, a është nënshkruar nga shtetasja Bukurie Haxhiraj, krahasuar me dokumentet model krahasimi (përshkruar në pikat c, d, e, f)? 5.4. Dokumenti objekt ekspertimi, (përshkruar në pikën b), në fletën numërtuar 28 (njëzet e tetë), në rekuizitën “Aplikanti” emër mbiemër Bukurie Haxhiraj dhe nënshkrimi (firmë), datë 9.12.2016, a është shkruar dhe nënshkruar (firmosur) nga shtetasja Bukurie Haxhiraj, krahasuar me dokumentet model krahasimi (përshkruar në pikat c, d, e, f) ?”.

8.1 Me shkresën nr. 768 prot, datë 06.03.2023, nga Instituti i Policisë Shkencore është dërguar Akti i Ekspertimit Tekniko Grafik Nr. 1956, datë 03.03.2023, në të cilin është konkluduar se: “ 1. Në lidhje me pyetjen për shenjën e vulës rrethore me tekst “REPUBLIKA E SHOIPËRISË, “A&B Grup” Sh.p.k., L. 11 Janari, 113-VLORË-ALBANIA”, të pasqyruar te dokumenti “Autorizim” datë 9.12.2016 (i cili pasqyrohet i skanuar në një CD-R) objekt ekspertimi, nuk mund të konkludojmë. Për të konkluduar duhet që dokumenti objekt ekspertimi, të na vihet në dispozicion në origjinal. (shih me sipër) 2. Tek dokumenti “APLIKIM PËR NDRYSHIME NË TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PËR SHOQËRITË KOLEKTIVE, KOMANDITE, ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, DHE TË THJESHTA” datë 09.12.2016 objekt ekspertimi: 2/1. Nënshkrimi (firmë) në emër të Bukurie Haxhiraj, i ndodhur në fletën e numërtuar “27” (fletën e dytë) të dokumentit të sipërcituar objekt ekspertimi, nuk është nënshkruar (firmosur) nga Bukurie Haxhiraj, krahasuar me modelet e paraqitura, në emër të saj. 2/2. Nënshkrimi (firmë) në emër të Bukurie Haxhiraj, i ndodhur te rekuizita “Nënshkrimi” në fletën e numërtuar “28” (fletën e tretë) të dokumentit të sipërcituar objekt ekspertimi, nuk është nënshkruar (firmosur) nga Bukurie Haxhiraj, krahasuar me modelet e paraqitura, në emër të saj. 2/3. Nënshkrimi i plotë (emër mbiemër firmë) në emër të Bukurie Haxhiraj, i ndodhur te rekuizita “Aplikanti” në fletën e numërtuar “28” (fletën e tretë) të dokumentit të sipërcituar objekt ekspertimi, nuk është shkruar e nënshkruar (firmosur) nga Bukurie Haxhiraj, krahasuar me modelet e paraqitura, në emër të saj.”.

8.2 Më datë 03.02.2023, me Procesverbal “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, është pyetur shtetasi Rrapo Xhaferraj i cili ka deklaruar ndër të tjera se: “Që në momentin e emërimit jam paraqitur për të bërë ndryshimet në QKB, si administrator falimentimi pranë kësaj shoqërie. Administratorit të mëparshëm Bukurije Haxhirajt i janë hequr të drejtat e përfaqësimit ndaj të tretëve, por ka qenë në drejtimin e shoqërisë si drejtore ekzekutive për administrimin e pasurisë. Kontrolli financiar bëhej nga ana ime, kjo për shkak sepse kërkesa për falimentim ishte bërë nga debitori dhe ishte bërë për riorganizim të shoqërisë dhe nuk mund t’ia merrja unë të gjitha kompetencat deri sa të shprehej me një vendim gjykata, për njohjen e kreditorëve dhe vazhdimin e procedurës. Në bashkëpunim me zyrën e financës mbylla llogaritë, bëra inventarin dhe paraqita në gjykatë bilancin paraprak të falimentimit. Të drejtat e mia i ushtroja me nënshkrimin tim dhe me vulën time si administrator falimentimi. Vula e shoqërisë “A&B” Group, i ishte lënë debitorit, shtetases Bukurije Haxhiraj për marrëdhëniet e brendshme. Nuk iu mor vula e shoqërisë, pasi Bukurija ishte si drejtore ekzekutive për drejtimin e shoqërisë dhe marrëdhëniet e brendshme. Në çdo marrëdhënie me të tretë, bankë, etj, përdorja vulën time, nuk njihej vula e shoqërisë “A&B Group”. Në të gjitha transfertat

bankare unë veproja me nënshkrimin tim.”. I pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore se kush i mbante marrëdhëniet me klientët, ai është përgjigjur se: “Marrëdhëniet i mbante stafi i shoqërisë, zyra e financës. Unë si administrator falimenti mbajta të njëjtin staf dhe unë raportoja çdo tre muaj gjykatën për të ardhurat dhe shpenzimet dhe gjendjen e llogarisë bankare. Kjo për shkak se shoqëria “A&B” Group ishte në riorganizim dhe nuk kishte dalë në likuidim, i cili u krye në vitin 2018. Pra, shoqëria vazhonte aktivitetin normal dhe gjeneronte fitim. Pra fitimi i gjeneruar që nuk ishte shumë i madh përdorej përsëri po brenda shoqërisë për pagimin e sigurimeve, pagat, furnizime, etj, pra përdorejshin për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë. Në kohën kur shoqëria filloi të krijonte likuiditete pra gjendje kesh në lekë apo monedha të ndryshme, ndodhi njoftimi nga banka BKT që unë nuk isha më administrator dhe më ishin hequr kompetencat me vendim gjykate, fakt për të cilin unë kam paraqitur edhe kallëzimin penal.”. I pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore se si kryheshin prej tij mbajtja e llogarive bankare dhe pasqyrave financiare vjetore, gjatë administrimit të shoqërisë në falimentim, ai është përgjigjur se: “Këto kryheshin nëpërmjet stafit drejtues që ishin personeli. Deri në momentin që Bukuri ka mbajtur stafin, unë bëja kontrollin e gjendjes bankare sipas ligjit për procedurat tatimore dhe hartimin e pasqyrave financiare në fund të çdo viti sipas ligjit për kontabilitetin, pasqyra këto të hartuara nga stafi i shoqërisë, të nënshkruara nga ana ime dhe të audituara nga eksperti i licencuar Arqile Mishtaku. Me pasqyrat financiare çdo tre muaj njiheshin kreditorët në gjykatë.”.

9. Mbi këto fakte, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë i është drejtuar kësaj Gjykate me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. 787, të vitit 2017, për veprat penale “Falsifikimi i dokumentave” dhe “Fshehjes së pasurisë pas falimentimit”, parashikuar nga neni 186 dhe 195 i Kodit Penal. Organi procedues, lidhur me kërkimin për pushimin e akuzës, ka arsyetuar ndër të tjera sa vijon:

“ 9.1 Në përfundim të hetimit të këtij procedimi penal rezulton se nuk provohet që shtetasja Bukurie Haxhiraj të ketë falsifikuar dokumentin “autorizim” datë 09.12.2016, pasi nga të dy aktet e ekspertimit të kryer nga ana e organit të prokurorisë nuk rezultojnë shkrimet dhe nënshkrimet e kësaj shtetaseje në cilësinë e Drejtores Ekzekutive të Shoqërisë dhe gjithashtu nuk provohet që ky autorizim të jetë shkruar apo nënshkruar as nga Administratori i falimentimit shtetasi Rrapo Haxhiraj. Në lidhje me pretendimet e të kallëzuarës së mund të jetë përpiluar nga shtetasi Agron Haxhiraj, rezulton që ky shtetas ka ndërruar jetë në vitin 2017.

9.2 Ndodhur në rrethanat kur dokumenti është i falsifikuar, por nuk provohet që nënshkrimet të jenë hedhur nga asnjë nga personat në hetim (kallëzues dhe shtetase e dyshuar), referuar gjithashtu kohës së përpilimit të tij datë 09.12.2016, si dhe përdorimit të tij deri në vitin 2017, ndodhemi para parashkrimit të ndjekjes penale sipas nenit 66 gërma (ç) të Kodit Penal, pasi vepra penale e parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal dënohet në maksimum me katër vjet burgim.

9.3 Në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 195 i Kodit Penal, “Fshehja e pasurisë pas falimentimit”, rezulton se palët kanë qenë në procese gjyqësore për falimentimin e shoqërisë dhe që të dy, si kallëzuesi dhe e kallëzuara rezultojnë në pozicione drejtuese, njëri administrator, Drejtor Ekzekutiv dhe tjetri Administrator i Falimentit sipas vendimit të gjykatës. Kallëzuesi pretendon se shtetasja Bukurie Haxhiraj ka përfutur një shumë prej 43.000 euro dhe ka hapur padi në gjykatë në datën 17.11.2017 për arkëtimin e kësaj shume nga ana e kësaj shtetaseje, padi e kthyer me të meta.

9.4 Nga hetimi, nuk provohet që asnjë nga këta shtetas (në mënyrë individuale apo në bashkëpunim) të ketë pasur dijeni për falsitetin e dokumentit "Autorizim" datë 09.12.2016, çka sjell marrëveshje të anës subjektive për kryerjen e kësaj veprë penale të parashikuar nga neni 195 i Kodit Penal, si palë të interesuara bashkarisht për shkak të pozicioneve drejtuese në shoqëri.

9.5 Në rrethana të tilla, duke qenë se nuk konstatohen elementë të ndonjë veprë tjetër penale që ndiqet kryesisht, ky procedim duhet të pushohet."

III. Vlerësimi i Gjykatës.

10. Gjykata, si shqyrtoi në tërësi aktet e hetimeve paraprake dhe dispozitat ligjore përkatëse konkludoi se kërkesa e prokurorisë nuk është e bazuar. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se është i nevojshëm kthimi i akteve prokurorit për plotësim të hetimeve, pasi në rastin konkret hetimet nuk janë të plota dhe se është e domosdoshme që aktet t'i kthehen prokurorit dhe të kryhen veprime të tjera hetimore.

10.1 Gjykata vlerëson të theksojë paraprakisht se neni 148/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: "*Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit*". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit. Një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale. Përcaktimi sa më i saktë i detyrave që ka secili aktor në procesin penal është një nga kërkesat kryesore që duhet të plotësojë kuadri kushtetues dhe ligjor në një shtet të së drejtës. Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror.

10.2 Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të specializuar për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Organi i prokurorisë është një nga mekanizmat e domosdoshëm që ndihmon në dhënien e drejtësisë penale. Ky organ i posaçëm ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Nisur nga rëndësia që kanë organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtruara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal.

10.3 Për të garantuar jo vetëm qenien aktive të organit të prokurorisë në ndjekjen penale dhe dënimin e personave të dyshuar si autorë të veprave penale, por edhe respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve ndaj të cilëve ngrihet akuza ose janë dëmtuar si pasojë e veprës penale konkrete, ligjvënësi ka parashikuar në disa dispozita të K.Pr.Penale mundësinë që palët në proces për çdo veprim që ata mendojnë se cenojnë të drejtat dhe liritë e tyre t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës për kontroll. Në këtë frymë, neni 278 i K.Pr.Penale parashikon se gjatë hetimeve paraprake për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit dhe të viktimës vendos gjykata. Kjo dispozitë është miratuar nga ligjvënësi në vitin 2002, në kuadër të një koordinimi sa më të mirë të dispozitave që u

japin palëve gjatë procesit të hetimeve paraprake disa të drejta procedurale. Më tej, në dispozitat e tjera të K.Pr.Penale, janë specifikuar disa nga rastet kur lejohet ankimi gjyqësor i vendimeve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake.

10.4 Gjithashtu, në nenet 291 dhe 329 të K.Pr.Penale, është parashikuar e drejta e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin dhe pushimin e procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake. Ky kontroll ushtrohet në funksion të parimit të ligjshmërisë së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të. Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, e drejta për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, pra për t'iu drejtuar një autoriteti të pavarur dhe të paanshëm, është në përputhje edhe me standartet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës. Në parim, ligjvënësi ia ka nënshtuar të gjitha veprimet hetimore paraprake kontrollit gjyqësor. Praktika njeh dy mënyra për ushtrimin e këtij kontrolli: ose nëpërmjet gjykatës së themelit ose nëpërmjet gjyqtarit hetues, i cili, në legjislacionet e disa vendeve, është organi kompetent për të kontrolluar të gjitha veprimet hetimore paraprake përpara se çështja t'i kalojë për gjykim gjykatës kompetente. Në fund është gjykata që ka të drejtë të shprehet për të gjitha veprimet hetimore, përfshirë edhe vendimin e pushimit të çështjes. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij vendimi duhet të konstatojë, nëse prokurori e ka pushuar çështjen në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.

10.5 Duke u kthyer në rastin konkret, kërkesa e organit të akuzës gjen parashikim në nenin 329/a të K.Pr.Penale, ku sanksionohet sa vijon: *“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328 të këtij kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes”*. Ndërsa në nenin 328, pika 1, të K.Pr.Penale përcaktohet se: *“Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: a) del qartë që fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; c) viktimja nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij; ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet; d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai; e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale; ë) i pandehuri vdes; f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj”*.

11. Në vijim, neni 329 i Kodit të Procedurës Penale ka parashikuar në mënyrë shteruese kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, të cilat janë:

11.1 Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes për kundërvajtjet penale mbi ankimin e të pandehurit, viktimës ose trashëgimtarëve e saj dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e akteve. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, por për njërën ose disa nga akuzat ka vendosur pushimin, ankimi ndaj vendimit të pushimit shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Në këtë rast ankimi shqyrtohet në prani të palëve, prokurorit, të pandehurit dhe me pjesëmarrjen e domosdoshme të mbrojtësit të tij dhe me praninë e viktimës ose trashëgimtarëve të saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim, në një seancë me dyer të mbyllura. Në

përfundim gjyqtari i seancës paraprake vendos: a) lënien në fuqi të vendimit të pushimit, kur çmon se janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi; b) *kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë*; c) kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq.

12. Në rastin objekt gjykimi, përpara se të analizojë nëse kërkesa e prokurorisë për pushimin e çështjes penale, është rezultat i një hetimi të plotë e të gjithanshëm dhe i interpretimit të drejtë të ligjit material e procedural, Gjykata vlerëson të analizojë shkurtimisht elementët objektivë dhe subjektivë të figurës së veprës penale *“Falsifikimi i dokumentave”*, të parashikuara nga neni 186 i K.Penal. Në nenin 186 të Kodit Penal parashikohet shprehimisht se: *“Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet.”*

12.1 Objekt i veprës penale të falsifikimit të dokumenteve është marrëdhënia juridike konkrete që garanton veprimtarinë e rregullt të organeve të administratës publike dhe të personave privatë në lidhje me hartimin, administrimin dhe lëshimin e dokumenteve nga veprimet ose mosveprimet kriminale, që sjellin si pasojë cenimin e ligjshmërisë së funksionimit të këtyre organeve, si dhe të drejtave apo interesave të ligjshme të shtetasve (për më shumë, shih vendimin nr. 84, datë 24.03.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). Veprat penale të falsifikimit të dokumenteve mbrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë të mirën juridike të besimit publik, për t’u identifikuar në besimin që shoqëria dhe shteti juridik i jep vërtetësisë së disa dokumenteve dhe sigurisë së tyre, ndërsa në mënyrë specifike është interesi specifik që garanton dokumenti i mirëfilltë në lidhje me origjinën dhe me përmbajtjen e tij (shih vendimin nr. 122, datë 18.04.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

12.1.1 Nga falsifikimi i dokumenteve mund të preken edhe interesat e ligjshme të shtetasve. Objekt material i krimit mund të jenë dokumentet zyrtare apo private të ndryshme, përveç atyre që parashikohen në dispozitat e veçanta të Kodit Penal. Neni 186 i Kodit Penal mbron aktet zyrtare dhe ato private, të cilat jo vetëm që duhet të plotësojnë disa elementë minimalë formalë (si identiteti i përpiluesit dhe të pranishmëve, data, përmbajtja dhe nënshkrimi), por që më tej në përmbajtjen e tyre, duhet të dokumentojnë juridikisht ekzistencën e një vullneti, gjendjeje apo marrëdhënieje të caktuar, në të cilën përpiluesi i saj ka detyrimin ligjor të pasqyrojë të vërtetën. Dispozita penalizon veprimin e rremë ose jo të vërtetë mbi shkresat që përbëjnë dokument publik apo privat me vlerë juridike.

12.1.2 Dokumentet përbëjnë një instrument të rëndësishëm për sigurinë juridike, shkëmbimet juridike, pra ato përbëjnë bazën e zhvillimit dhe përparimit të një shoqërie të qytetëruar. Kësisoj, këto shkëmbime duhet të mbështeten në dokumente të vërteta dhe autentike që vërtetojnë dhe certifikojnë situatat e ndryshme juridike në të cilat bazohen dhe krijohen marrëdhëniet në fjalë, aq të rëndësishme për marrëdhëniet juridike dhe besimin në vërtetësinë e dokumenteve. Falsifikimi i dokumenteve përfshihet në veprat penale të ashtuquajtura “formale”, ku parashikohet vetëm fakti penal, çka do të thotë se kjo vepër konsiderohet e kryer me realizimin e veprimit kriminal, pavarësisht nga ardhja e

pasojës, e cila në këtë rast, nuk është e domosdoshme për konfigurimin e kësaj veprë penale sipas paragrafit të parë (shih vendimet nr. 277, datë 07.11.2024 dhe nr. 134, datë 25.04.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

12.2 Nga ana objektive, me falsifikim të dokumenteve kuptojmë paraqitjen në to të rrethanave të rreme ose përpilimin e një dokumenti krejtësisht të falsifikuar, si dhe përdorimin e tyre. Falsifikimi mund të bëhet në dy mënyra: ose duke vepruar drejtpërdrejt mbi të, duke bërë shtesa, korrigjime, ndryshime dhe çdo veprim tjetër material (*falsifikim material*) ose duke falsifikuar përmbajtjen e tij, pa prekur formën e dokumentit (*falsifikim intelektual*). Ligjvënësi ka parashikuar shprehimisht se figura e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” nga ana objektive kryhet në dy forma: (i) nëpërmjet “falsifikimit të dokumenteve” dhe nëpërmjet (ii) “*përdorimit të dokumenteve të falsifikuara*” nga vetë personi që e ka kryer falsifikimin apo nga një person tjetër që ka interes për përdorimin e tij (shih vendimin nr. 186, datë 05.06.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). E drejta jonë materiale penale në këtë kuptim ka adaptuar parimin latin “*Falsus est quidquid veritate non est sed pro veritate adseveratur* (dokumenti i rremë është diçka e pavërtetë, por që është paraqitur si i vërtetë). Në formën e parë të kryerjes është e domosdoshme zbulimi i autorësisë së falsifikimit dhe në pamundësi të saj përjashtimi nga kjo autorësi e pjesëmarrësve në proces (shih vendimin nr. 113, datë 27.03.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë). Po ashtu, që të arrihet në konkluzionin se jemi përpara kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal në formën e përdorimit, do të duhet, së pari të provohet përdorimi i aktit, por njëkohësisht të vërtetohet dijenia e subjektit të veprës penale se akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme, sikundër të jetë evident dhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar (shih vendimin nr. 00-2023- 690 (134), datë 25.04.2023 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

12.3 Që të kemi falsitet, duhet të kemi një dokument që të sanksionojë një vullnet për pasqyrimin jo të vërtetë, pra të përmbajë një deklaram që nuk i përgjigjet të vërtetës. Për qëllim të konfigurimit të elementit subjektiv të veprës penale të dhënies së të dhënave të pavërteta në një dokument, gjykata duhet të shqyrtojë me kujdes nëse sjellja e veprimit të subjektit të veprës penale përcaktohet nga një qëllim i vetëdijshëm për të bërë një pasqyrim të pavërtetë të realitetit. Në rastin e një kërkesë/dokumenti/formulari të hartuar me të dhëna të pavërteta, aspekti voluntiv i të vepruarit nga mosveprimi/pasqyrimi i faktit a rrethanës së vërtetë e integron aktin në një vërtetim të dhënë të faktit të pavërtetë e jo të plotë, pasi nuk përputhet me faktin. Elementi subjektiv si sjellje e qëllimshme, e vullnetshme e dhënies së një të dhëne jo të vërtetë duke e njohur atë, e shtyn autorin të dëshirojë për të favorizuar veten apo të tjerët me këtë falsitet. Ajo shfaqet në formën e jashtme të dokumentit, në mënyrë që ajo t’i besohet faktit “*conclusentia*”. Përgjegjësia është e personit që plotëson dokumentin si titullar apo si përfutës i pasojave të dorëzimit të atij dokumenti.

12.4 Gjykata vlerëson se për të vërtetuar falsitetin e një dokumenti, nisur nga natyra e figurës së veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe për të arritur në përfundimin nëse subjekti i veprës penale në procedim penal është autor i kryerjes së asaj veprë (të kryer nëpërmjet ndërhyrjes teknike, fshirjes, shtesave apo paraqitjes të të dhënave të rreme në një dokument) nevojitet konkluzioni kategorik i specialistit të kësaj fushe, i cili materializohet në aktin e ekspertimit teknik të dokumentit. Mungesa e konkluzionit kategorik të ekspertit lidhur me falsitetin e dokumentit, i përftuar nëpërmjet një akti ekspertimi të përpiluar dhe të marrë si provë në përputhje me rregullat procedurale penale të çon detyrimisht në mungesën e ekzistencës së veprës penale të “Falsifikimit të dokumentit”, pasi

mungon objekti i saj. *Nëse i pandehuri akuzohet për kryerje të veprës penale të falsifikimit nëpërmjet përdorimit të dokumentit të falsifikuar, që vepra penale të quhet e konsumuar mjafton që të provohet dijenia e subjektit të veprës penale për falsitetin e dokumentit, të cilin me dashje e përdor për interesat e veta apo të personave të tjerë (për më shumë, shih vendimin nr. 617, datë 16.06.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

12.5 Ndërkohë përveç objektit të përgjithshëm që cenohet, ligjvënësi ka parashikuar si forma të veçanta kryerjen e kësaj vepre në disa rrethana rënduese. Konkretisht kryerja e falsifikimit *i)* në bashkëpunim, ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, si dhe *ii)* falsifikimin nga personi që ka për detyrë ta lëshojë dokumentin. Pra, ligjvënësi përveç elementeve të domosdoshëm të veprës penale të falsifikimit, i cili konsiston në paraqitjen e rrethanave të rreme, për efekt të përgjegjësisë penale ka përcaktuar rrethana që rëndojnë përgjegjësinë penale të subjektit që e kryen atë. Megjithëse figura e veprës penale është e njëjta, format e kryerjes së veprës penale nuk konkurojnë me njëra-tjetrën. Për efekt të përcaktimit të përgjegjësisë penale do të vlerësohet gjithmonë rrethana e posaçme pa të cilën vepra penale nuk do të ishte kryer (*Shih vendimin nr. 288, datë 07.11.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

12.6 Gjykata vlerëson se ana subjektive e kryerjes së veprës penale të falsifikimit të dokumenteve kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e dashjes direkte. Në kryerjen e kësaj vepre penale dashja direkte mund të evidentohet në këto forma: *a)* dijenia e personit të ngarkuar me lëshimin e dokumentit se në përmbajtjen e aktit po paraqet të dhëna të rreme ose hartimi i një akti të falsifikuar dhe se përdor një dokument të falsifikuar; *b)* dijenia e subjektit të veprës penale që nuk e kanë prodhuar dokumentin e falsifikuar se akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme; *c)* dëshirës për t'i kryer veprimet e mësipërme. Motivi apo qëllimi nuk janë elemente të domosdoshëm përbërës të figurës së krimit të falsifikimit.

12.7 Në lidhje me subjektin e veprës penale, Gjykata vlerëson se, duke iu referuar paragrafit të parë dhe të dytë të nenit 186 të Kodit Penal, subjekti i veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve" është i përgjithshëm, që do të thotë mjafton që të plotësohen dy kushtet e përgjithshme: mosha dhe përgjegjshmëria e subjektit. Ndërkohë që paragrafi i tretë i nenit 186 të Kodit Penal, ku përcaktohet shprehimisht se: "*Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin...*", kërkon që subjekti të jetë i posaçëm. Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, subjekt i kësaj figure vepre penale mund të jetë subjekti i posaçëm i cili është i ngarkuar me ligj me një detyrë publike apo shtetërore. Përveç cilësive të veçanta që duhet të ketë subjekti, duhet që akti të jetë lëshuar gjatë ushtrimit të detyrës në bazë të kompetencave që i njeh ligji, si dhe akti të prodhojë pasojën juridike të dëshiruar. Pra, sipas Gjykatës së Lartë subjekt i posaçëm janë vetëm zyrtarët publikë. Funksioni publik sipas përkufizimit të doktrinës u njihet personave të cilët kontribuojnë në formimin e vullnetit të entit publik ose e përfaqësojnë në marrëdhëniet me të tretët; të gjithë ata që kanë pushtet autoritar; të gjithë ata që kanë pushtet vërtetues.

12.8 Lidhur me sa më lart, ky trup gjykues vlerëson se në rastin konkret, nga ana objektive, vepra penale është konsumuar nëpërmjet formës së "përdorimit të dokumenteve" dhe jo nëpërmjet formës së "falsifikimit intelektual të dokumenteve", sikurse ka arsyetuar organi i akuzës. Sikurse e kemi theksuar në pjesët e mësipërme të këtij vendimi, për t'u konsideruar e konsumuar vepra penale "Falsifikimi i dokumenteve", në formën e përdorimit, duhet të provohet përdorimi i aktit, por njëkohësisht të

vërtetohet dijenia e subjektit të veprës penale se akti i përdorur prej tij përmban të dhëna të rreme, sikundër të jetë evident dhe qëllimi i fitimit apo çdo lloj interesi tjetër personal nga përdorimi i këtij dokumentacioni të falsifikuar. Në rastin konkret, referuar akteve dhe provave të grumbulluara dhe administruara në fazën e hetimeve paraprake, si: *a)* kallëzimi i shtetasit Rrapo Xhaferaj, i cili ka sqaruar se autorizimi datë 09.12.2016, i përdorur nga ana e shtetases Bukurie Haxhiraj pranë QKB-së dhe pranë BKT-së, është i falsifikuar; *b)* deklaratimet e punonjësës së QKB-së, e cila ka marrë aplikimin e shtetases Bukurie Haxhiraj, nga ku ka rezultuar se aplikimi është bërë pikërisht nga shtetasja Bukurie Haxhiraj, e cila ka plotësuar edhe formularin përkatës të aplikimit; *c)* informacioni i ardhur nga BKT, Dega Vlorë, nga ku ka rezultuar se ekstrakti i ndryshuar në QKB, ku pasqyrohet heqja e shtetasit Rrapo Xhaferaj si administrator i falimentimit të shoqërisë dhe emërimi i shtetases Bukurie Haxhiraj si administratore e shoqërisë, është depozituar në bankë nga vetë shtetasja Bukurie Haxhiraj, e cila rezulton të ketë veprime në llogarinë bankare nga data 28.02.2017 deri në datë 21.03.2017, kur në bankë është paraqitur shtetasi Rrapo Xhaferaj, në cilësinë e administratorit të falimentimit; *d)* faktit se në datën 09.12.2016, shtetasja Bukurie Haxhiraj është paraqitur personalisht pranë QKB-së, duke aplikuar dhe dorëzuar dokumenta që ndryshonin kohëzgjatjen e administratorit të shoqërisë “A&B Group” sh.p.k dhe ku pjesë e këtyre dokumentave kanë qenë: *i)* Autorizimi datë 09.12.2016, i lëshuar nga shtetasi Rrapo Xhaferaj, i cili autorizonte shtetasen Bukurie Haxhiraj për kryerjen e veprimeve në QKB; *ii)* Karta e identitetit të shtetases Bukurie Haxhiraj; *iii)* vendimi i ortakut të vetëm Agron Haxhiraj, datë 09.12.2016 dhe *iv)* vendimi nr. 185, datë 23.11.2016 i Gjykatës së Apelit Vlorë; *e)* faktin që shtetasja Bukurie Haxhiraj përpara fillimit të procedurës së falimentimit të shoqërisë “A&B Group” ka qenë administratore e kësaj shoqërie dhe ku pas fillimit të procedurës së falimentimit, ka mbajtur pozicionin e drejtoreshës ekzekutive për administrimin e pasurisë së kësaj shoqërie etj, krijohen dyshime të arsyeshme se shtetasja Bukurie Haxhiraj ka konsumuar elementët e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, nëpërmjet formës së përdorimit të një dokumenti tërësisht të falsifikuar dhe jo nëpërmjet ndërhyrjeve mekanike.

13. Duke u rikthyer në çështjen objekt shqyrtimi, referuar faktit penal, parashtrimeve të referuara në kërkesën e organit të akuzës, Gjykata çmon se kërkesa e Prokurorit për pushimin e procedimit penal për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit, nuk është rezultat i një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. Për këtë arsye, Gjykata konform nenit 329, paragrafi i tretë, shkronja “b”, i K.Pr.Penale, vlerëson se aktet duhet t’i kthehen organit të prokurorisë për vazhdimin e hetimeve, sipas drejtimit të përcaktuar në këtë vendimmarje.

14. Për sa u argumentua më sipër, Gjykata vlerëson se aktet e procedimit penal nr. 787, të vitit 2017, duhet t’i kthehen prokurorit në mënyrë që të vazhdojë hetimet, duke u thelluar më tej, në disa drejtime, si në vijim:

- i. Duke marrë në konsideratë faktin se sipas teorisë së të drejtës penale, si dhe praktikës gjyqësore në vijimësi, vepra penale e “Falsifikimit të dokumenteve”, kategorizohet si vepër penale e karakterit vazhdues, Gjykata vlerëson se organi i akuzës, duhet të kryejë hetime të mëtejshme hetimore, duke administruar dokumentacionin përkatës pranë të gjitha bankave të nivelit të dytë, si dhe pranë të gjitha institucioneve kompetente shtetërore, fusha e përgjegjësisë së të cilave afekton veprimtarinë e përditshme të shoqërive tregtare, me qëllimi verifikimin e faktit nëse autorizimi datë 09.12.2016, i nënshkruar nga shtetasja Bukurie Haxhiraj është përdorur/dorëzuar edhe pranë këtyre autoriteteve publike apo private dhe nëse

po, përcaktimin e datës së përdorimit të këtij akti, për efekt të përcaktimit të fillimit të afatit të parashkrimit për këtë veprë penale;

- ii. Në vijim të detyrës së mësipërme, organi që ushtron ndjekjen penale mund të ripyese sërish në cilësinë e personit që mund të ketë dijeni për veprën penale shtetasin Rrapo Xhaferaj, si dhe shtetasen Bukurie Haxhiraj, për të cilën ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ka përdorur një dokument të falsifikuar, me qëllim marrjen e informacioneve shtesë apo sqarimin e rrethanave të reja që mund të dalin si rrjedhojë e hetimeve që do të kryejë organi i akuzës;
- iii. Në rast se pas verifikimeve që do të kryhen sipas drejtimit të përcaktuar si më lart, rezultojnë të mos jenë kryer ndonjë veprim tjetër juridik/tregtar duke përdorur aktin “Autorizim datë 09.12.2016”, ose edhe në rast se mund të jenë kryer, por që në zbatim të nenit 66 të Kodit Penal, ndjekja penale duhet të pushojë për shkak të kalimit të afateve të parashkrimit, atëherë organi i akuzës duhet që në momentin e paraqitjes së kërkesës së re, krahas kërimit për pushimin e procedimit penal nr. 787/2017, duhet që në zbatim të neneve 190 dhe 391, të Kodit të Procedurës Penale, të parashtrojë edhe kërkimin për deklarimin e falsitetit të aktit të mësipërm, si dhe asgjësimin e tij;
- iv. Referuar përmbajtjes së vendimit nr. 1483 datë 22.10.2018, ku Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. 787 të vitit 2017, Prokurores së çështjes, si dhe përmbajtjes së kërkesës objekt gjykimi për pushimin e procedimit penal nr. 787/2017, rezultojnë se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nuk ka kryer asnjë veprim hetimor sipas drejtimit të përcaktuar nga Gjykata në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 195 i Kodit Penal, por thjesht është mjaftuar me hartimin e një paragrafi të përgjithshëm *“Nga hetimi, nuk provohet që asnjë nga këta shtetas (në mënyrë individuale apo në bashkëpunim) të ketë pasur dijeni për falsitetin e dokumentit “Autorizim” datë 09.12.2016, çka sjell mungesë të anës subjektive për kryerjen e kësaj veprë penale të parashikuar nga neni 195 i Kodit Penal, si palë të interesuara bashkarisht për shkak të pozicioneve drejtuese në shoqëri”*. Ndërkohë, sikurse e kemi theksuar në pjesët e mësipërme të këtij vendimi, nga provat e administruara në funksion të procedimit penal nr. 787/2017, krijohen dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se shtetasja Bukurie Haxhiraj ka patur dijeni se po përdor një dokument të falsifikuar, me qëllimin final fshehjen e pasurisë së personit juridik për t’iu shmangur pasojave juridike të falimentimit. Si rrjedhojë, Gjykata urdhëron organin e akuzës që të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të konfigurimit të mundshëm të veprës penale të parashikuar nga neni 195 i Kodit Penal, të cilat duhet të fokusohen, por pa u kufizuar, në administrimin e dokumentacioneve përkatëse të dorëzuara nga shoqëria pranë organeve të ndryshme licencuese/inspektuese/monitoruese të veprimtarisë financiare dhe ekonomike të shoqërisë tregtare; caktimit të një eksperti/ekspertëve përkatës që mund të auditojë, verifikojë dhe evidentojë “veprime financiare të pa/rregullta të kryera nga organet përkatëse të shoqërisë tregtare”, si dhe veprime të tjera procedurale të cilat mund të jenë të ndërlidhura edhe me veprimet hetimore për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”.

15. Gjykata evidenton se dhënia e këtyre përgjigjeve nga ana e organit të akuzës, përcakton përkërisht drejtimin e hetimeve të mëtejshme në lidhje me këtë çështje, për të cilën është kërkuar pushimi i çështjes. Në këtë kontekst, drejtimi i hetimeve në vijim do të jetë i kanalizuar, por duke mos u kufizuar, në veprimet hetimore të sipërcituara, si dhe çdo e dhënë tjetër që i përket ngjarjes si më sipër, duke i ballafaquar rezultatet, me provat e tjera të administruara nga organi i akuzës, për të evidentuar më tej, nese këto prova, të vlerësuara në unison ndërmjet tyre, janë të mjaftueshme për të mbështetur eventualisht akuzën në fazën e mëtejshme të gjykimit apo duhet të vijohet me pushimin e çështjes.

16. Për të gjitha arsyet e shpjeguara si më sipër, kjo Gjykatë, bazuar në *nenin 329/b pika 3, në lidhje me nenin 329, pika 3, shkronja "b" të KPP*, vlerëson se duhet të vendosë kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve paraprake, duke mbajtur parasysh drejtimin e tyre, e duke mos u kufizuar vetëm në të, me qëllim arritjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm.

17. Për një hetim efektiv, në kuadër të një procesi të rregullt e të drejtë ligjor, brenda një afati të arsyeshëm kohor, veprimet e mësipërme hetimore, duke mbajtur parasysh kompleksitetin e veprimeve hetimore, duhet të kryhen brenda 4 (katër) muajve, afat i cili fillon të llogaritet nga data e marrjes formë të prerë të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 329, pika 3, shkronja "b" dhe 329/b, pika, 4 të Kodit të Procedurës Penale si dhe në nenin 186 të Kodit Penal,

VENDOSI

1. Kthimin e akteve që i përket procedimit penal nr. 787/2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për vazhdimin e hetimeve të mëtejshme, duke përcaktuar drejtimin e thellimit të tyre, sipas detyrave shtesë të përcaktuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.
2. Urdhërohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për kryerjen e këtyre veprimeve brenda katër muajve nga dita e njoftimit të vendimit të formës së prerë.
3. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Prokurorit të çështjes Flora Çela si dhe Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
4. Shpenzimet procedurale si dhe ato gjyqësore sikurse janë kryer.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Vlorë, sot në datë 13.05.2025

SEKRETARE

BELINDA HAXHIAJ



GJYQTARE

ALBA NGRESI

